



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 1163 prot.

Tiranë, më 22. 06. 2026

**Lënda:** Rekomandim për marrjen e masave pozitive për trajtimin me bursë, për të gjitha kategoritë përfituese, sipas VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, të ndryshuar.

**MINISTRISË SË ARSIMIT**

Rruga e Durrësit, Nr. 23,  
TIRANË

**BASHKISË KORÇË**

Lagjja 12, Bulevardi “Shën Gjergji”,  
KORÇË

**BASHKISË TEPELENË**

Rruga “Ali Pashë Tepelena”, Sheshi “Lord Bajron”,  
TEPELENË

**BASHKISË SARANDË**

Rruga “Abedin Dino”, Nr. 11,  
SARANDË

**BASHKISË MALIQ**

Bulevardi “Rinia”, Maliq,  
KORÇË

**BASHKISË DIVJAKË**

Pranë Sheshit “Santa Barbara”,  
DIVJAKË

**BASHKISË GRAMSH**

Sheshi "Kamber Dermyshe", Bulevardi "10 Korriku",  
GRAMSH

**BASHKISË PEQIN**

Bulevardi “Mustafa Gjinishi”,  
PEQIN

**BASHKISË BELSH**

Rruga “Haziz Dervishi”,  
BELSH

**BASHKISË DIMAL**

Rruga “Dimal”, Lagjja “18 Tetori”,  
URA VAJGURORE

**BASHKISË POLIÇAN**

Lagjja “Qendër” Poliçan, 5404,  
POLIÇAN

**BASHKISË ROSKOVEC**

Qendër Roskovec, Rruga “Ymer Pirra”, Ndërtesa Nr. 15,  
ROSKOVEC

**BASHKISË KONISPOL**

KONISPOL

**BASHKISË MIRDITË**

Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen,  
MIRDITË

**BASHKISË HIMARË**

Spile,  
HIMARË

**BASHKISË FUSHË-ARRËZ**

Qendër qyteti, Rruga Sh5,  
FUSHË ARRËZ

**BASHKISË LIBOHOVË**

Libohovë,  
GJIROKASTËR

**BASHKISË KOLONJË**

Sheshi Rilindja, Ersekë,  
KOLONJË

**BASHKISË PUKË**

Sheshi “Gjergj Kastrioti (Skënderbeu)”,  
PUKË

**BASHKISË DELVINË**

Lagjja “Sinan Ballaci”, Rruga “Nazif Haderi”,  
DELVINË

**BASHKISË SKRAPAR**

Lagjja “Çlirimi”, Rruga “Arkitekt Kasëmi”, Nr. 1, Çorovodë,  
SKRAPAR

**BASHKISË HAS**

Qyteti Krumë,  
HAS

**BASHKISË PUSTEC**

Pustec,  
KORÇË

**BASHKISË KËLCYRË**

Sheshi “Musa Fratari”,  
KËLCYRË

**BASHKISË CËRRIK**

Lagja Nr. 2, Rruga “Bulevardi Gjinnazi 1962”,  
CËRRIK

**BASHKISË KURBIN**

Lagja Nr. 3,  
LAÇ

**BASHKISË RROGOZHINË**

Lagjja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori”,  
RROGOZHINË

**BASHKISË LIBRAZHD**

Sheshi “Gjorg Golemi”,  
LIBRAZHD

**BASHKISË FINIQ**

Finiq,  
VLORE

**BASHKISË LUSHNJË**

Lagjja “Kongresi”,  
LUSHNJË

**BASHKISË MEMALIAJ**

Rruga “Tafil Buzi”, Godina Nr.7,  
MEMALIAJ

**BASHKISË FIER**

Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr. 15,  
FIER

**BASHKISË ELBASAN**

Rruga “Qemal Stafa”,  
ELBASAN

**BASHKISË GJIROKASTËR**

Sheshi “Çerçiz Topulli”,  
GJIROKASTËR

**BASHKISË PATOS**

Rruga “Unaza”,  
PATOS

**BASHKISË PRRENJAS**

Rruga “Skënderbej”,  
PRRENJAS

**BASHKISË SHIJAK**

Lagjja “Erzen”,  
SHIJAK

**BASHKISË BULQIZË**

Lagjja “Minatori”,  
BULQIZË

**BASHKISË KUÇOVË**  
Blloku Nr.1, Lagja “Tafil Skendo”,  
KUÇOVË

**BASHKISË DIBËR**  
Bulevardi Elez Isufi,  
PESHKOPI

**BASHKISË VLORË**  
Sheshi “4 Heronjtë”,  
VLORË

**BASHKISË KRUIJË**  
Sheshi “Skënderbej”,  
QENDËR KRUIJË

**BASHKISË KAVAJË**  
Bulevardi “Josif Buda”, Ndërtesa Nr. 16,  
KAVAJË

**BASHKISË DURRËS**  
Sheshi “Liria”, 2000,  
DURRËS

**BASHKISË BERAT**  
Bulevardi “Republika”,  
BERAT

**BASHKISË MALËSI E MADHE**  
Koplik Qendër,  
MALËSI E MADHE

**BASHKISË VAU I DEJËS**  
Rruga “Qafa e Gurit”,  
VAU DEJËS

**BASHKISË POGRADEC**  
Bulevardi “Rreshit Çollaku”,  
POGRADEC

**BASHKISË VORË**

Rruga “Unaza”, Nr. 73,  
VORË

**BASHKISË MAT**

Sheshi “Kastriotët”, Nr. 1,  
BURREL

**BASHKISË SELENICË**

Selenicë,  
VLORE

**BASHKISË KLOS**

Rruga “Jaho Hoxha”, ndërtesa nr. 2, hyrja nr. 2,  
KLOS

**BASHKISË PËRMET**

Shëtitorja “Abdyl Frashëri”,  
PËRMET

**BASHKISË TROPOJË**

Sheshi “Azem Hajdari”, Bajram Curri,  
TROPOJË

**BASHKISË MALLAKASTËR**

Lagjja “18 Prilli”,  
BALLSH

**BASHKISË KUKËS**

Sheshi “Skënderbej”, Lagjja 5,  
KUKËS

**BASHKISË DEVOLL**

Lagjja Nr. 1, Rr. “24 Tetori”, Nr. 5,  
DEVOLL

**BASHKISË LEZHË**

Lagjja “Skënderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”,  
LEZHË

**BASHKISË KAMËZ**  
Bulevardi "Nënë Tereza",  
KAMËZ

**BASHKISË SHKODËR**  
Rruga "13 Dhjetori", Nd. 9, Nr. 1,  
SHKODËR

**BASHKISË DROPULL**  
Jergucat,  
GJIROKASTËR

**BASHKISË TIRANË**  
Sheshi "Skënderbej", Nd. 2,  
TIRANË

***Për dijeni:* KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",  
TIRANË

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup> është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar<sup>2</sup>, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Në nenin 32, pika 1, shkronja "f", të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar (LMD), përcaktohet se: "*Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*".

Gjatë shqyrtimit të 61 (gjashtëdhjetë e një) ankesave të paraqitura<sup>3</sup> nga prindër të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në njësitë e vetëqeverisjes vendore Tiranë dhe Korçë, Komisioneri konstatoi pretendime të përsëritura lidhur me përjashtimin e nxënësve nga përfitimi i bursave të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike. Nga shqyrtimi i këtyre ankesave rezultoi informacion i besueshëm se problematika e konstatuar mund të prekte një kategori më të gjerë nxënësish sesa subjektet ankuese.

Për rrjedhojë, mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja "c", të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, sipas të cilit Komisioneri ka kompetencën të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji,

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>3</sup> Ankesat janë paraqitur gjatë viteve 2024 dhe 2025.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Urdhrin nr. 67, datë 23.06.2025, filloi kryesisht (ex officio) procedurën administrative për shqyrtimin e çështjes së përjashtimit nga përfitimi i bursave të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, referuar parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.

**I. Parashtrimi i fakteve referuar çështjeve të trajtuara gjatë vitit 2024 dhe 2025, lidhur me përjashtimin e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në njësitë e vetëqeverisjes vendore Tiranë dhe Korçë, nga përfitimi i bursave.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesave të depozituara gjatë viteve 2024-2025, ka konstatuar diskriminimin e subjekteve ankues nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Korçë, duke kërkuar në vijim, marrjen e masave të menjëhershme për:

- për trajtimin me bursë për vitin shkollor 2024-2025, sipas kriterit të parashikuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, si dhe shmangien e situatës së krijuar në vijim.
- për të shmangur situatën e krijuar në rastet konkrete, është rekomanduar që njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa, për një bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë procesit të hartimit kuotave në proporcion me nevojat dhe kërkesat e depozituara për trajtimin me bursa.

Një ndër arsyt e parashtruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në lidhje me mosakordimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, ka qenë pamundësia për të mbështetur të gjithë nxënësit që plotësonin kriteret dhe kishin paraqitur kërkesë për përfitimin e bursës. Sipas këtyre njësive, kjo situatë ka ardhur si pasojë e numrit të kufizuar të kuotave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të cilat nuk kanë qenë në përpjesëtim me numrin e aplikimeve të paraqitura, pasi rezulton të ketë qenë ndjeshëm më i lartë se numri i bursave të vëna në dispozicion.

Nga shqyrtimi i 21 çështjeve gjatë vitit 2026, Komisioneri ka konstatuar se Këshilli Bashkiak i Korçës, me Vendimin nr. 86, datë 29.08.2025, ka përcaktuar kriteret e përparësisë për shpërndarjen e bursave. Sipas pikës 3/h të këtij vendimi, në rast konkurrimi ndërmjet aplikantëve, përparësi u jepet atyre që kanë dorëzuar më parë dokumentacionin. Në zbatim të këtij kriteri, rezulton se kuotat e bursave janë plotësuar vetëm me aplikantët që kanë dorëzuar dokumentacionin deri më datën 17.10.2025, duke sjellë përjashtimin nga përfitimi i bursës të nxënësve të tjerë që plotësonin kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, por që kanë paraqitur dokumentacionin pas kësaj date.

Në analizë të rasteve të trajtuara nga Komisioneri, përveç sa më sipër u evidentuan dhe problematikat e mëposhtme:

- mungesa e një akti administrativ ku të ishin përcaktuar qartë kriteret dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar;
- mungesa e një procedure të qartë për trajtimin me bursa ku aplikantët të pajiseshin me një dokument, përmes së cilit të vërtetohej fakti i aplikimit, dorëzimit të dokumentacionit përkatës dhe kërkesa për përfitimin nga kriteri specifik sipas VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar;
- në dokumentacionin e kërkuar aplikuesve, si në rastet kur ata trajtoheshin me ndihmë ekonomike, pagesë paaftësie apo kishin statusin e jetimit, nga ana e njësisve të vetëqeverisjes vendore, është kërkuar edhe dokumentacion që disponohet nga institucionet vartëse të tyre, dhe në këto raste, mosdorëzimi i këtyre dokumenteve nga aplikuesit ka rezultuar në përjashtimin e aplikimeve për bursë;
- kërkesa e lidhur me dokumentacionin që duhet dorëzuar nga aplikantët sipas kriterëve të pikës 2.1/c, të VKM-së 666, konkretisht të *vërtetimit nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes*, të cilin e dispononin njësitë e vetëqeverisjes vendore, në dosjet e personave që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike, u konstatua kërkesë e tepërt dhe e panevojshme duke qenë se administrohet prej tyre, si dhe krijonte për aplikantët një barrë të tepërt;
- nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, është interpretuar në mënyrë të gabuar pika 2.1, shkronja c), të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, duke trajtuar me bursë vetëm ato nxënës në pamundësi financiare, që plotësonin dy kriterë kumulative që familjet e tyre të ishin me ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë.

Në pikën 2.1, shkronja c, të VKM-së nr. 666 parashikohet shprehimisht se: “... *përfitojnë bursë... c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë*”.

Duke krahasuar parashikimet ligjore në VKM nr. 666, me kushtet e vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatohet se kushti kumulativ dhe cilësimet: pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, janë togfjalëshja të shtuar pa u mbështetur në dispozitat ligjore përkatëse nga ana e njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe që nuk citohen në pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së. VKM-ja nr. 666, e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë, në pamundësi financiare.

Nga shqyrtimi i rasteve të trajtuara rezulton se problematikat e konstatuara nuk kanë qenë vetëm pasojë e mungesës së kuotave financiare, por edhe e mangësive procedurale, e interpretimeve të gabuara të legjislacionit dhe e vendosjes së kriterëve shtesë të pambështetura në ligj si rrjedhojë,

fëmijët që i përkasin familjeve në nevojë janë përballur me vështirësi të pajustificuara në aksesin ndaj një mase mbështetëse të krijuar pikërisht për të garantuar vijimin e arsimimit të tyre.

## II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresat nr. 1094 prot, datë 15.07.2025 dhe nr. 1094/2 prot., datë 17.10.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, duke i kërkuar informacion, lidhur me praktikën e ndjekur për dhënien e bursave, sipas VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
2. Me shkresën Nr. 1095 prot, datë 15.07.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar 61 njësive të vetëqeverisjes vendore, duke i kërkuar informacion, lidhur me praktikën e ndjekur prej tyre për dhënien e bursave, sipas VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
3. Për shkak të mungesës së përgjigjes nga 12 prej bashkive, me shkresën nr. 979/1 prot., datë 17.10.2025, i është dërguar sërish kujtesë për dhënien e informacionit të kërkuar përmes shkresës nr. 1095 prot., datë 15.07.2025. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, 8 prej subjekteve dërguan informacion.
4. Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit, 57 njësi të vetëqeverisjes vendore, si dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, vunë në dispozicion një pjesë të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, i cili lidhej, ndër të tjera, me:
  - numrin e kërkesave/aplikimeve për përfitimin e bursave, sipas secilës kategori përfituese të përcaktuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, për vitet shkollore 2022–2023, 2023–2024 dhe 2024–2025, si dhe numrin e bursave të mbuluara përmes kuotave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe atyre të financuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
  - numrin e bursave të kërkuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore dhe numrin e bursave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas kategorive përfituese, për secilin nga vitet shkollore;
  - numrin e fëmijëve/nxënësve që kanë përfituar bursë në bazë të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, duke specifikuar kategorinë ose kriterin përfitues për secilin rast;

- numrin e nxënësve aplikantë dhe përfitues të bursave, të cilët i përkasin pakicës kombëtare rome dhe pakicës kombëtare egjiptiane, për vitet shkollore 2022–2023, 2023–2024 dhe 2024–2025;
- aktet administrative të miratuara (kur ekzistojnë), përmes të cilave janë përcaktuar kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e bursave sipas VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar;
- dokumentacionin e kërkuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për shqyrtimin e kërkesave për bursë;
- procedurën e ndjekur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për shpërndarjen e kuotave të bursave ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas kategorive përfituese të përcaktuara në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, duke përfshirë numrin e bursave të kërkuara dhe të miratuara për secilën njësi gjatë viteve shkollore 2022–2023, 2023–2024 dhe 2024–2025;
- informacion mbi dijeninë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit lidhur me problematikat e hasura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbulimin me bursë të të gjithë nxënësve që plotësonin kriteret ligjore, si pasojë e numrit të kufizuar të kuotave të miratuara, si dhe mbi masat e ndërmarra ose të planifikuara për adresimin e kësaj situatë.

5. Vetëm një numër i kufizuar njësisish të vetëqeverisjes vendore kanë vënë në dispozicion informacion të plotë dhe të detajuar, në përputhje me kërkesën e Komisionerit. Megjithatë, nga të dhënat e siguruar rezultoi se:

- nga 61 bashkitë të cilave u është kërkuar informacion lidhur me numrin e kërkesave/aplikimeve për përfitimin e bursave sipas kategorive përfituese të përcaktuara në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, 42 bashki kanë raportuar se kanë administruar kërkesa për përfitimin e bursave, ndërsa vetëm 30 prej tyre kanë raportuar se i janë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me kërkesa për miratimin e kuotave përkatëse gjatë tre viteve të fundit shkollore;
- 23 bashki kanë referuar numrin e fëmijëve/nxënësve, që kanë përfituar nga parashikimet e VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, duke specifikuar kriterin për të cilin kanë përfituar;
- 38 bashki kanë përcjellë informacion mbi ndarjen e bursave sipas burimit të financimit, duke specifikuar numrin e bursave të mbuluara nga kuotat e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe ato të financuara nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Vetëm në 18 njësi kanë mbuluar me bursa një pjesë të nxënësve që kanë aplikuar për të qenë përfitues sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar. Ndërsa, njësitë e tjera nuk kanë miratuar bursa veç atyre të akorduara nga ana e Ministrisë së Arsimit apo asaj të Financave;
- Në 30 raste nuk rezultoi që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kishin kërkuar mbështetje financiare të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar nga ana e Ministrisë së Arsimit.

- Vetëm 2 prej 61 bashkive kanë dhënë informacion sa nxënës përfitues të bursave i përkasin pakicave rome dhe atyre egjiptiane;
- Vetëm 3 prej njësive kanë referuar se kanë të miratuar një procedurë, përmes së cilës janë përcaktuar kriteret dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.

Nga analizimi i përgjigjeve të vëna në dispozicion nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, **u konstatua mungesa e një akti administrativ sa i përket parashikimit të kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e bursave**, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar. Gjithashtu, **u evidentua se njësitë e vetëqeverisjes vendore pavarësisht faktit që kanë pasur kërkesa/aplikime të shtuara dhe kanë pasur mundësinë dhe detyrimin të mbulonin përmes skemave financiare nga fondet e veta, nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete lidhur me to.**

### III. Legjislacioni i zbatueshëm<sup>4</sup>

1. Nenet 18, 57, 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>5</sup> (KEDNJ);
3. Protokolli 12, KEDNJ;
4. Nenet 2, 3, 4, 28, 29 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>6</sup>;
5. Nenet 1, 5, 6, 19, 28, të Ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.;
6. Nenet 1, 2, 6, 18, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
7. Nenet 1, 2, 3, 17, 22, 32, pika 1, shkronja c dhe ë, Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;

### IV. Arsyetimi ligjor

Qëllimi i përbashkët i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara dhe të analizuar në kuadër të procesit të kufizimit të kuotave nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore në zbatim të VKM-së nr. 666/2019 është që nëpërmjet tyre të garantohen të drejtat e fëmijëve për trajtim dinjitoz dhe në interesin e tyre më të lartë, në fushën e arsimit.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim pavarësisht nga vendbanimi i personit. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

<sup>4</sup> Në aneksin 1, citohet legjislacioni i plotë në të cilin është mbështetur Komisioneri për nxjerrjen e këtij rekomandimi.

<sup>5</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

<sup>6</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr ligjin 7531, datë 11.12.1991.

Fëmijët, si subjekte të së drejtës dhe bartës të të drejtave themelore të njeriut, gëzojnë të drejtën për arsimim. Kjo e drejtë garantohet nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, e cila përcakton se çdo fëmijë ka të drejtë të aksesojë arsimin mbi bazën e mundësive të barabarta, pa asnjë formë diskriminimi. Në këtë kuadër, shteti ka detyrimin të sigurojë realizimin efektiv të kësaj të drejte përmes masave ligjore, institucionale dhe administrative përkatëse.

Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim, pavarësisht nga vendi ku ai banon apo ndjek shkollën: qoftë ajo në zonë urbane apo rurale.

Fëmijët gëzojnë të drejtën për një mbrojtje të posaçme, konkretisht ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, sanksionon se realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke u bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim.

Legjislacioni në fuqi në përputhje me standardet ndërkombëtare parashikon që e drejta për arsim garantohet pa diskriminim për të gjithë fëmijët. Por garantimi i të drejtës për arsim nuk nënkupton vetëm pranimin në shkollë dhe prezencën fizike të fëmijëve në klasa, por që fëmijët të marrin një arsim cilësor dhe të barabartë për të gjithë.

Në kuadër të garantimit të së drejtës për arsimim dhe respektimit të parimit të barazisë së mundësive, legjislacioni shqiptar ka parashikuar vazhdimisht mekanizma ligjorë dhe masa mbështetëse që synojnë nxitjen e arsimimit dhe edukimit të fëmijëve. Këto masa përfshijnë lehtësira të veçanta për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë ekonomike, si dhe për ata që i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane, me synimin për të parandaluar përjashtimin social dhe për të garantuar akses të barabartë në sistemin arsimor.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030<sup>7</sup> ka si vizion krijimin e një sistemi të mbrojtjes sociale që ofron një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë, duke garantuar një standard jetese dinjitoz përgjatë gjithë ciklit të jetës. Në kuadër të këtij vizioni, një ndër objektivat strategjik<sup>8</sup> të Strategjisë është përmirësimi i shënjestrimit të fëmijëve, vajzave dhe djemve, nëpërmjet skemave financiare të ndjeshme gjinore dhe programeve të mbrojtjes sociale të orientuara posaçërisht ndaj tyre. Gjithashtu, Strategjia synon përmirësimin e përfitimeve në kuadër të skemës së ndihmës ekonomike dhe forcimin e bashkëpunimit ndërsektorial me fokus fëmijët, me qëllim promovimin e mirëqenies, zhvillimit dhe përfshirjes së tyre sociale. Strategjia evidenton ekzistencën e disa mekanizmave mbështetës, si bonusi i lindjes, stimujt financiarë për regjistrimin

---

<sup>7</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.3.2024

<sup>8</sup> Objektivi specifik/strategjik A3.

në shkollë dhe vaksinimin, tekstet shkollore falas, bursat mësimore dhe forma të tjera mbështetje të ofruara nga institucionet qendrore dhe vendore.

Dokumenti thekson gjithashtu rëndësinë e identifikimit dhe analizimit të të gjitha përfitimeve dhe shërbimeve që ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve, me qëllim hartimin e politikave më efektive dhe ndërtimin e skenarëve të rinj mbështetës, bazuar edhe në praktikat më të mira ndërkombëtare. Në këtë drejtim, strategjia parashikon zhvillimin e analizave të vazhdueshme për të vlerësuar ndikimin e këtyre skemave në mirëqenien e fëmijëve dhe për të mundësuar përmirësimin e tyre në përputhje me nevojat reale të kësaj kategorie.

Në të njëjtën frymë, edhe Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026<sup>9</sup> vendos në qendër të politikave arsimore parimin e gjithëpërfshirjes dhe të barazisë në arsim. Në vizionin e saj, kjo strategji synon ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, të bazuar në parimet e barazisë dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës, i cili garanton formim cilësor për të gjithë individët dhe kontribuon si në mirëqenien personale të tyre, ashtu edhe në zhvillimin demokratik dhe integrimin evropian të vendit. Në mënyrë të veçantë, strategjia parashikon masa mbështetëse për fëmijët që ndodhen në rrezik braktisjeje shkollore dhe për grupet vulnerabël, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që i përkasin grupeve të marginalizuara shoqërore, fëmijët e rikthyer nga emigracioni, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe fëmijët që i përkasin pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane. Në këtë mënyrë, dokumenti strategjik njeh nevojën për masa të diferencuara dhe mbështetje të posaçme për kategoritë që përballen me pengesa sociale, ekonomike apo kulturore në ushtrimin e së drejtës për arsim.

Nga analiza e dispozitave dhe objektivave të kësaj strategjie rezulton se shteti shqiptar ka marrë përsipër angazhimin për të garantuar jo vetëm aksesin formal në arsim, por edhe përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore të fëmijëve që i përkasin kategorive vulnerabël. Në këtë kuadër, parashikimi i masave dhe paketave mbështetëse për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë përbën një instrument të rëndësishëm për realizimin efektiv të së drejtës për arsim, reduktimin e pabarazive sociale dhe garantimin e një standardi jetese sa më dinjitoz për këta fëmijë. Këto masa përfaqësojnë një shprehje konkrete të detyrimit pozitiv të shtetit për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës dhe për të siguruar barazi reale të mundësive në fushën e arsimit.

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor dhe strategjik të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se situata e konstatuar gjatë hetimit administrativ **evidenton problematika serioze në zbatimin e mekanizmave të mbështetjes së parashikuar për garantimin e aksesit të barabartë në arsim për nxënësit vulnerabël**, duke përbërë njëkohësisht një cenim të detyrimit pozitiv të institucioneve shtetërore për të garantuar ushtrimin efektiv të së drejtës për arsim.

**Nga informacioni i administruar rezultoi se, megjithëse numri i kërkesave për përfitimin e bursave ka qenë i konsiderueshëm dhe në rritje gjatë viteve shkollore 2022–2023, 2023–2024**

<sup>9</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021

dhe 2024–2025, vetëm një pjesë e këtyre kërkesave është mbuluar përmes kuotave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ose nga fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore. Njëkohësisht, u konstatua se një numër i konsiderueshëm njësish të vetëqeverisjes vendore nuk dispononin procedura të qarta administrative për administrimin dhe shqyrtimin e kërkesave për bursë, ndërsa në disa raste janë zbatuar praktika dhe kritere që nuk gjejnë mbështetje në parashikimet e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.

Të dhënat e mbledhura gjatë hetimit tregojnë se nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore, **vetëm një numër i kufizuar prej tyre kanë mbuluar me bursa nxënës përfitues nga fondet e tyre**, ndërsa shumica nuk kanë miratuar akte administrative apo procedura të posaçme që të garantojnë transparencë, siguri juridike dhe trajtim të njëjtë të aplikantëve. Gjithashtu, është evidentuar **mungesa e një praktike të unifikuar në administrimin e kërkesave**, kërkimi i dokumentacionit të panevojshëm që disponohej nga vetë administrata publike, si dhe interpretime të ndryshme të kritereve të përcaktuara në VKM-në nr. 666, duke sjellë si pasojë përjashtimin e nxënësve që plotësonin kushtet ligjore për përfitim.

**Në këtë kontekst, shqetësues mbetet fakti se rritja e vazhdueshme e numrit të aplikimeve për bursë nuk është shoqëruar me një rritje proporcionale të kuotave të vëna në dispozicion.** Për pasojë, një numër i konsiderueshëm nxënësish që i përkasin familjeve në nevojë kanë mbetur jashtë skemës së mbështetjes financiare, pavarësisht se kanë përmbushur kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Kjo situatë ka cenuar efektivitetin e masave të ndërmarra nga shteti për mbështetjen e arsimit të fëmijëve vulnerabël dhe ka krijuar diferenca të pajustificuara në aksesin ndaj një përfitimi që synon të garantojë vijimin e arsimit dhe të reduktojë rrezikun e përjashtimit social.

Për më tepër, rastet e trajtuara nga Komisioneri, në të cilat është konstatuar diskriminim në lidhje me moskordimin e bursave, dëshmojnë se problematika nuk lidhet vetëm me burimet financiare të disponueshme, por edhe me mënyrën e zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet përgjegjëse. Moszbatimi i njëjtë i legjislacionit, vendosja e kushteve shtesë të paparashikuara nga aktet normative dhe mungesa e procedurave të qarta administrative kanë krijuar barriera të pajustificuara për fëmijët që i përkasin familjeve në nevojë, duke cenuar mundësinë e tyre për të përfituar nga masat mbështetëse të garantuara me ligj.

Në vlerësimin e Komisionerit, këto rrethana bien ndesh me detyrimin pozitiv të institucioneve publike për të garantuar akses efektiv dhe të barabartë në arsim, si dhe me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit të sanksionuara në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 2 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. **Për rrjedhojë, situata e konstatuar evidenton nevojën për ndërhyrje institucionale dhe normative me qëllim garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të skemës së bursave, rritjen e transparencës së procedurave, si dhe sigurimin e aksesit efektiv të fëmijëve që i përkasin shtresave vulnerabël në masat mbështetëse të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.**

## V. Konkluzione

Bazuar në analizën ligjore të sipërcituar dhe në faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ, Komisioneri arrin në konkluzionin se situata e evidentuar i vendos në kushte të pafavorshme nxënësit e familjeve në nevojë, fëmijët romë dhe egjiptianë dhe kategoritë e tjera vulnerabël të parashikuara në VKM-në nr. 666/2019. Dështimi i institucioneve përgjegjëse për të ofruar bursën e parashikuar ligjërisht **nuk mund të justifikohet me mungesën e fondeve apo kuotat e kufizuara**, pasi detyrimi ligjor për garantimin e kësaj të drejte është i shprehur dhe i detyrueshëm. Institucionet qendrore dhe vendore kanë shkelur nenin 11 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili u ngarkon atyre detyrimin për të marrë masa pozitive – si dhe nenet 28 dhe 19 të Ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, duke mos ofruar mbështetjen e posaçme të parashikuar për nxënësit e familjeve në nevojë.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Sipas pikës 30 në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022: “Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.” Kjo parashikon një përgjegjësi të qartë ligjore të Ministrisë për ofrimin e bursave për nxënësit në pamundësi financiare.
- Nga shqyrtimi i trendit të aplikimeve dhe të dhënave të administruara, rezulton se numri i aplikimeve për bursa në vitet e fundit, ka qenë në rritje, por as njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe as Ministria e Arsimit **nuk kanë ndërmarrë masa për të rritur kuotat** apo për të siguruar që të gjitha aplikimet që plotësojnë kriteret ligjore të marrin përfitim.
- Nga ana e Ministrisë së Arsimit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin mësimor 2025-2026, por edhe për vitet paraardhëse shkollore.

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 11, Veprime pozitive, parashikon: “Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshtetimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.”

Si dhe në nenin<sup>10</sup> 6, pika 1 të tij, parashikon se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.”

<sup>10</sup> Neni 6, Trajtimi i ndryshëm i përligjur

GJEDNJ-ja ka theksuar se “e drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara në KEDNJ po ashtu është shkelur kur shtetet ... nuk i trajtojnë ndryshe personat situata e të cilave janë dukshëm të ndryshme.<sup>11</sup> Në mënyrë të ngjashme, direktivat e BE-së për mos-diskriminim parashikojnë shprehimisht mundësinë e veprimit pozitiv, ku thuhet: “Me synimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk do të pengojë asnjë Shtet Anëtar të mbajë ose të miratojë masa specifike për të parandaluar ose të kompensojë disavantazhet e lidhura me (një shkak të mbrojtur<sup>12</sup>).

Lejueshmëria e marrjes së masave pozitive në favor të grupeve të pafavorizuara përforcohet më tej nga udhëzimet e lëshuara nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të të drejtave të njeriut të OKB-së. Këto organe kanë theksuar që masat e tilla duhet të jenë të përkohshme në natyrë, dhe jo të shtrihen në kohë apo hapësirë përtej asaj që është e nevojshme për të adresuar pabarazinë në fjalë.<sup>13</sup>

Në çështjen *Ponomaryovi v. Bullgarisë* (Nr. 5335/05), 21 qershor 2011, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka cituar ndër të tjera se: “...arsimimi është një e drejtë që gëzon mbrojtjen e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Gjithashtu arsimit është një lloj tejet i veçantë i shërbimeve publike, që jo vetëm u sjell përfitime atyre që e përdornin atë, por që ka, po ashtu, edhe një funksion më të gjerë shoqëror dhe ishte i pazëvendësueshëm për të çuar më tej të drejtat e njeriut.

Referuar Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm<sup>14</sup> dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

Shtetasit, pjesë e grupeve vulnerabël, përballen me problematika më të gjëra se gjendja e rënduar ekonomike e tyre të cilat bëhen pengesë për integrimin e tyre në shoqëri. Vetë angazhimet e shtetit Shqiptar për këto problematika janë tregues i qartë i ekzistencës së tyre.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se praktika e ndjekur nga institucionet e qeverisjes vendore dhe Ministria e Arsimit, duke i mohuar të drejtën për të përfituar bursë sipas parashikimeve të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, i ka ekspozuar nxënësit që

---

<sup>11</sup> ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44. Similarly, ECtHR, *Pretty v. UK* (No. 2346/02), 29 April 2002, para. 88.

<sup>12</sup> Racial Equality Directive, Article 5; Employment Equality Directive, Article 7; Gender Goods and Services Directive, Article 6; and also with a slightly different formulation: Gender Equality Directive (Recast), Article 3.

<sup>13</sup> Handbook on European non-discrimination law fq.38

<sup>14</sup> Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

ndjekin arsimin parauniversitar në institucionet arsimore publike, ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, **masa e duhur** për rregullimin e situatës diskriminuese është **marrja e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse, që të sigurojnë dhënien e tarifës së bursës së mohuar**, për nxënësit, që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, referuar parashikimeve të VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, të ndryshuar.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Ministria e Arsimit duhet të kenë në konsideratë që kategoritë përfituese të nxënësve, parashikuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, të ndryshuar, ndodhen në kushte më vulnerabël, me qëllim garantimin, njësoj si për të gjithë nxënësit e tjerë, të së drejtës për arsimim dhe barazi në përfitimin e mbështetjes financiare.

Në bazë të ligjit 69/2012 “*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, bashkitë kanë detyrime në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e tyre.

**Komisioneri vlerëson se Ministria e Arsimit duhet të marrë masa konkrete për të bashkëpunuar, koordinuar dhe konsultuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë procesit të përcaktimit të kuotave, duke i përshtatur ato në mënyrë proporcionale me nevojat reale të bashkive. Ky proces është i domosdoshëm për të mundësuar vlerësimin dhe adresimin efektiv të problematikave të evidentuara, me qëllim shmangien e situatave të tilla në të ardhmen dhe garantimin e barazisë në aksesin ndaj përfitimeve, duke parandaluar sjellje me efekt diskriminues.**

Përveç sa më sipër, Komisioneri vlerëson të nevojshme të sjellë në vëmendje të Ministrisë së Arsimit domosdoshmërinë e rishikimit dhe qartësisht të mëtejshëm të pikës 2.1, shkronja “c”, të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, pasi riformulimi i saj në vitin 2022 vijon të krijojë paqartësi në interpretim dhe zbatim, me pasojë rrezikun e përjashtimit të padrejtë të përfituesve.

Formulimi aktual i kësaj dispozite e lidh përfitimin e bursës me mosndjekjen e arsimit bazë, duke përjashtuar nga skema e mbështetjes nxënësit që, ndonëse ndodhen në gjendje të vështirë ekonomike, ndjekin rregullisht arsimin bazë. Në këtë mënyrë, dispozita nuk garanton mbështetje të drejtpërdrejtë për të gjithë nxënësit në nevojë dhe nuk reflekton plotësisht qëllimin e aktit nënligjor, i cili synon nxitjen dhe mbështetjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët, pjesë e familjeve në vështirësi ekonomike.

Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se mbështetja me bursë duhet të orientohet drejt nxënësve, pjesë e familjeve në nevojë që janë të regjistruar dhe ndjekin arsimin bazë, me qëllim garantimin e aksesit efektiv në arsim dhe parandalimin e braktisjes shkollore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim eliminimin e situatës diskriminuese të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, sa i përket mohimit të dhënies së bursave, referuar parashikimeve të VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 32, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

### **REKOMANDON:**

1. Ministrinë e Arsimit dhe njësité e vetëqeverisjes vendore, të marrin masa konkrete për:
  - sigurimin e numrit të kuotave të nevojshme për dhënien e bursave, për të gjitha kategoritë përfituese, sipas VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar;
  - bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë procesit të hartimit kuotave në proporcion me nevojat e bashkive.
2. Njësité e vetëqeverisjes vendore, të marrin masat për hartimin e një procedure konkrete, përmes të cilës të përcaktohen kriteret, dokumentacioni, pajisja e aplikantëve me një dokument aplikimi, përmes së cilit të vërtetohet fakti i dorëzimit të dokumentacionit përkatës dhe kërkesa për përfitimin nga kriteri specifik sipas VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666; datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar.
3. Ministrinë e Arsimit, të mbajë në konsideratë rekomandimet e përcjella nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes shkresës nr. 974/1 prot., datë 02.06.2026, lidhur me ndryshimet e sugjeruara të projektvendimit *“Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” i ndryshuar”*.

4. Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijani, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**

## ANEKS 1

Baza Ligjore në të cilën është mbështetur Komisioneri për nxjerrjen e rekomandimit

### **1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

#### **Neni 18**

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

#### **Neni 57**

1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.
2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.
3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.
4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.
5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.
6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.

#### **Neni 122**

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.
2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.
3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

## **2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>15</sup> (KEDNJ)**

### **Neni 14**

“Ndalimi i diskriminimit”

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

## **3. Protokolli 12, KEDNJ**

### **Neni 1**

“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

## **4. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>16</sup>**

### **Neni 2**

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t’ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.
2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

### **Neni 3**

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

---

<sup>15</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

<sup>16</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. ligjin 7531, datë 11.12.1991.

2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

#### **Neni 4**

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

#### **Neni 28**

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;

e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

#### **Neni 29**

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;

(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

### **5. Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.**

#### **Neni 1**

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

2. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

## **Neni 5**

1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjisllacionin shqiptar.

2. Në shkollat publike arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm të lartë janë falas.

## **Neni 6**

1. Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor.

2. Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.

3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.

4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.

5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

7. Veprimtaria e institucioneve në sistemin arsimor parauniversitar dhe e punonjësve të tyre është transparente dhe e bazuar në llogaridhënie ndaj përfituesve të shërbimit arsimor.

8. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e nxënësve, e punonjësve arsimorë, e prindërve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë, më poshtë "prindër", për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t'u dëgjuar për këto pikëpamje.

9. Sistemi arsimor parauniversitar funksionon mbi bazën e decentralizimit dhe autonomisë së institucioneve arsimore.

10. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e organizimit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit.

11. Shërbimi arsimor mbështetet dhe vlerësohet mbi bazën e standardeve. Vlerësimi është i brendshëm dhe i jashtëm.

## **Neni 19**

Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 28**

1. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:
  - a) ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transfertat e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
  - b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
  - c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
  - ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.
3. Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.
4. Njësia bazë e qeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet:
  - a) nxënësit e familjeve në nevojë;
  - b) nxënësit me arritje të shkëlqyera;
  - c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;
  - ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

## **6. Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”**

### **Neni 1**

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

### **Neni 2**

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

- b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;
- c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;
- ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;
- e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

## **Neni 6**

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.
2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

## **Neni 18**

1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.
3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:
  - e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;
  - ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;
  - f) të ndërmarrin veprime konkrete.

## **7. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar**

### **Neni 1**

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

### **Neni 2**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

### **Neni 3**

1. “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

### **Neni 17**

1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

- a) krijimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore apo profesionale;
- b) financimin e institucioneve arsimore apo profesionale;
- c) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;
- ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.

2. Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

3. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, veçanërisht shqetësimi seksual, i studentëve, nxënësve dhe punëmarrësve në institucionet arsimore.

4. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përsheptimin e barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen e përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe këto masa ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

5. Ndalimi i diskriminimit sipas këtij neni zbatohet në të gjitha nivelet e arsimit, si dhe në institucionet publike dhe ato private që ofrojnë shërbime arsimore apo profesionale për publikun”.

## **Neni 22**

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

## **Neni 32**

1. Komisioneri ka kompetencë:

...c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

...ë) t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;